



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 79/12
Prishtinë, më 26.09.2012, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontic, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Sali Asllanaj, Hykmete Bajrami, Xhevdet Neziraj, Albana Fetoshi dhe Muhamet Mustafa.

Mungoi: Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Kushtrim Aliu dhe Albulena Gashi (praktikant).

Gjithashtu ishin të pranishëm: Bedri Hamza Ministër i Financave, Ali Sadriu dhe Ramiz Lladrovci nga Komisioni për Mbikëqyerjen Financave Publik, Alexander Beetz, Lukas Fischer, Ramadan Islami, Rejhane Zylfijaj nga GIZ, monitorues nga KDI, OSCE.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit dt. 19.09.2012;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar mbi reformën e Bordit Ekzekutiv;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar;**
5. **Raportim nga Ministri i Financave lidhur me zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-221 dhe Ligjin nr. 04/L-116;**
6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-87 për Parkun Kombëtar "Sharri", me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
7. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-87 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**

8. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-21 për Mbrojtjen e Konsumatorit, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri;
9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-082 për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion;
10. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-216 mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë;
11. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Naser Osmani propozoi që pika e dhjetë të shqyrtohet si pika e tretë e rendit të ditës.

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet njëzëri me ndryshimet në rirenditjen e pikave të rendit të ditës. Pika e dhjetë bëhet pika e tretë dhe më pas bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës sipas radhës.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e komisionit dt. 19.09.2012

Kryetarja konstatoi se procesverbali miratohet pas vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-216 mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë

Naser Osmani sqaroi se në raportin e grupit punues me amendamente, më tepër janë qartësuar disa nene në aspektin gjuhësor dhe teknik. Ndihet nevoja në amendamentin 8 të bëhet një plotësim shtesë. Ajo qfarë është propozimi më i rëndësishëm ka të bëjë me pranimin e propozimit për rritjen e limitit të sigurimit të depozitave nga 2,000 € në 5,000€, dhe kjo është pranuar duke e marr parasysh përvojat apo praktikrat e shteteve tjera e sidomos anëtarëve të BE-së. Për këtë do të doja mendimin e Ministrit të Financave.

Bedri Hamza konfirmoi se ministria e financave është pajtuar që limiti i sigurimit të depozitave të jetë 5,000€. E kemi diskutuar edhe me bankat të cilat kanë pasur disa rezerva mirëpo, megjithatë në fund kemi arrit që të jemi të pajtim edhe këto institucione.

Në vazhdim filloi proceduar e votimit të amendamenteve. Amendamentet 1-7 u miratuan njëzëri.

Naser Osmani tek amendamenti 8 duhet të ndryshohet fjala “këshilltar”, me fjalën “përfaqësues” dhe ky ndryshim duhet të bëhet në të dy vendet ku përmendet, pasi që bordet nuk kanë këshilltar në punën e tyre.

Latif Gashi në këtë amendament kam vërejtje te fjala “mund“, për arsye që në ligj duhet të jetë e precizuar qartë veprimi, dhe nuk duhet të lihet si çështje fakultative apo sipas dëshirës së bordit. Konsideroj se duhet të jetë duhet ose ndonjë mënyrë tjetër që përcakton karakterin obligues.

Kryetarja vlerësoi se është e nevojshme të hiqet fjala mund dhe teksti të fillon me fjalën bordi menagjues fton dhe pastaj vazhdon teksti, si dhe bëhet ndryshimi i fjalës këshilltar me fjalën përfaqësues, në të dy pjesët ku përmendet në këtë nen.

Më pas vazhdoi proceduara e votimit të amendamenteve. Amendamenti 8 i miratua njëzëri me ndryshimet e bëra në komision. Po ashtu edhe amendamentet tjera prej 9-13, u miratuan njëzëri.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Miratohet Raporti me amendamente i Grupit Punues të Komisionit për Buxhet dhe Financa për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-216 mbi themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë. Raporti me amendamente procedohet për shqyrtim dhe miratim në procedurë të mëtutjeshme të Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar mbi reformën e Bordit Ekzekutiv

Bedri Hamza informoi se projektligji është propozuar për të përkrahur ndryshimet që janë bërë në FMN lidhur me procedurat për zgjedhjen e bordit ekzekutiv. Ne nuk mundemi me ndërrue gjendjen brenda FMN-së, dhe ajo qfarë duhet të bëjmë është të jemi në harmoni me politikat dhe ndryshimet që janë bërë.

Pas arsyetimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin për Ratifikimin e amendamentit të neneve të Marrëveshjes së Fondit Monetar Ndërkombëtar mbi reformën e Bordit Ekzekutiv.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar

Kryetarja theksoi se me këtë projektligj është kërkuar të bëhet dhënia e pëlqimit për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në FMN dhe që këto kuota janë burim financiar për shtetet anëtare pjesëmarrëse në këtë institucion dhe shuma e pjesëmarrjes, përcakton edhe të drejtën më të madhe në qasje në kredi dhe në të drejtën e votimit për vendet anëtare. Rritja e kuotës, vjen si rezultat i dinamikës së rritjes globale dhe zvogëlimit të kapaciteteve kredituese të FMN-së dhe nevojës më të madhe për kredi nga ky institucion.

Bedri Hamza sqaroi se edhe më këtë projektligj, kërkohet që të bëhet harmonizimi me ndryshimet që janë bërë brenda FMN-së, përkatësisht me rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në këtë institucion. Nuk prodhojnë ndonjë obligim aktual për buxhetin e Republikës së Kosovës.

Sali Asllanaj theksoi rritja e kuotës do të duhej të shkoj edhe me rritjen e prodhimeve dhe të ekonomisë. Përndryshe do të ketë nevojë për ndarje buxhetore shtesë dhe duhet dikush me mirëmbajtë atë pagesë.

Bedri Hamza theksoi se rritja e kuotës bëhet nga të gjitha vendeve anëtare edhe Kosova e rrit konten e vetë. Nuk prodhon detyrimisht obligim ti paguajmë këto fonde dhe ti depozitojmë në FMN. Por ne marrim një lloj obligimi ose një garancë që në rast të kërkesës nga FMN-ja, si shtet ti përgjigjemi kërkesave të këtij institucioni, siç edhe i kemi marr obligimet me rastin e ratifikimit të marrëveshjes për anëtarësim në FMN.

Kryetarja projektligji nuk prodhon kosto shtesë dhe për të realizuar kuotën prej 25 %, Qeveria e Kosovës ka të ndarë edhe pjesën e mjeteve prej 7.1 milion. Me këtë projektligj jepen zotime të cilat i merr qeveria në raport me FMN-në në të ardhmen.

Pas arsyetimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendit të miratojë Projektligjin për rritjen e kuotës së Republikës së Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

6. Raportim nga Ministri i Financave lidhur më zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 03/L-221 dhe Ligjin nr. 04/L-116

Kryetarja theksoi se sipas planit të veprimit për monitorimin e ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi të cilin e ka miratuar grupi punues, është paraparë që aktiviteti i parë në procesin e monitorimit të fillojë me raportimin e ministrit të financave në komision për nivelin e zbatueshmërisë së ligjit. Në këtë takim të pranishëm janë edhe kryetari i komisionit për mbikëqyerjen e financave publike dhe zv. kryetari parë, të cilët janë caktuar nga komisioni i tyre, të marrin pjesë në aktivitetet e përbashkëta të grupit punues për monitorim. Për këtë qëllim, sipas rregullit e kemi ftuar ministrin për raportim që ti jap disa informata se sa ka zbatueshmëri ky ligj në praktikë dhe a ka raste që ndonjë nën i këtij ligji, nuk është zbatuar sa duhet apo ka pas ndonjë problem apo ndonjë vështërsi gjatë punës praktike në zbatueshmërinë e këtij ligji. Paraprakisht i kemi formuluar edhe disa pyetje konkrete dhe ia kemi dërguar Ministrin për të marrë përgjigjet e caktuara.

Bedri Hamza theksoi se Ministria e Financave i ka pranuar pyetjet e drejtuar nga komisioni dhe kemi përgatitura përgjigjet e caktuara. Në vazhdim ministria raportoi në pyetjet e ngritura si në vijim: LMFP-ja është ligj bazë në fushën e menaxhimit të financave publike, ndërsa përmes ligjit të buxhetit jepen shpjegime shtesë sa i përket menaxhimit të parasë publike. Gjatë vitit 2012 janë bërë plotësimet e duhura me qëllim që këtij ligji ti jepet përparësi mbi të gjitha ligjet tjera sa i përket menaxhimit të parasë publike. Ministria e Financave ndër të tjera ka nxjerr akte nënligjore që përcaktohen me këtë ligj, të cilat edhe i përmendi. Më pas njoftoi se Ministria e Financave në bashkëpunim me Komisionin Evropian në vitin 2010 ka aprovuar Rregullën financiare për menaxhim financiar dhe kontroll e cila është në harmoni me parimet e kontrollit të brendshëm të financave publike të themeluar nga Këshilli i Evropës. Po ashtu Ministria në bashkëpunim me Komisionin Evropian, duke u bazuar në Dokumentin e Politikave për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike të aprovuar nga Qeveria e Kosovës në prill të vitit 2011, ka hartuar doracakun për Menaxhim Financiar dhe Kontroll dhe përmendi procedurat e caktuara. Këto procedura janë shpallur nga Ministri i Financave në konferencën e mbajtur më 20 maj 2011 me ZKA dhe ZKF të organizatave buxhetore dhe si të tilla janë në përputhje me kërkesat e Nenit 6.3 pika (i),(ii) dhe (iii). Monitorimi i respektimit të këtyre procedurave bëhet nga Njësia Qendrore Harmonizuese, përmes listave vet vlerësuese të raportuara nga Organizatat Buxhetore dhe monitorimeve të drejtpërdrejta tek këto organizata. Sipas Nenit 7, Paragrafi 1 të LMFP-së, Përgjegjësia për menaxhimin e investimeve të autorizuar i është bartur Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Investimet e autorizuar bëhen në përputhje të plotë me nenet 8 dhe 9 të LMFP-së. Efikasiteti dhe efektiviteti i investimeve të autorizuar kontrollohet nga komiteti i likuiditetit i formuar nga Thesari dhe BQK. Ministria e Financave ka në plan që në të ardhmen këto dy njësi të udhëhiqen nga një drejtor i përgjithshëm.

Ali Sadriu pyeti ministrin se si është menduar të organizohet dhe funksionon drejtoria e buxhetit. Meqë mendohet të ketë një drejtor të përgjithshme dhe dy njësi, si do të quhen këto njësi dhe si do të funksionojë në përgjithësi ky proces.

Bedri Hamza theksoi se aktualisht ka një lloj dualizmi mes departamenteve të buxhetit dhe ne mendojmë se ky duhet me qenë një departament i buxhetit me një drejtor të përgjithshëm, me sektor brenda këtij departamenti, që mund të jetë sektori për komuna dhe për organizatat buxhetore në nivelin qendror.

Muhamet Mustafa theksoi nëse krashohet me vendet tjera, ky ligj është mjaft kërkuar dhe i komplikuar. Mua më interesojnë tri çështje. Çështja e parë që dua të pyes ka të bëjë me përgatitjen dhe menaxhimin e buxhetit, megjithëse në ligj procedurat në përgatitjen e buxhetit janë të përcaktuara mirë, do të ishte mirë të shihej nëse disa nga këto procedura janë tepër të komplikuar në mënyrë që të kemi dispozita më të qarta. Sa i përket granteve për komunat është një formulë automatike, dhe ma merr mendja se është përsosur mjaft mirë kjo formulë, edhe pse regjistrimi i popullsisë mund të nxjerr telashe të reja. Gjithashtu pagat kanë hyrë në sistem, ndërsa mallrat e shërbimet janë problem për prokurimin publik. Ajo qfarë për mua është problematike në çështjen e menaxhimit të financave publike janë projektet afatgjate të investimeve kapitale. Këtu natyrisht ministritë e shumta, nganjëherë komunat, sidomos me ato që janë shpenzuesit më të mëdha të buxhetit që menaxhojnë projekte të mëdha kapitale, në këtë kontekst më intereson që ministri të tregojë përvojat e ministrisë së financave, sa bëhen analiza për kualitetin e projekteve kapitale apo a bëhen studime të fizibilitetit apo analiza të kost-benefit projekteve që ministrit i prezantojnë. A është zgjidhur me një akt nënligjor i cili në mënyrë të qartë tregon se para ndarjes së mjeteve buxhetore për një projekt të tillë afatgjatë, do të duhej të bëhej studimi i fizibilitetit. Çështja e dytë ka të bëjë me faktin që ne kemi një thezaur ku derdhen të gjitha të ardhurat dhe kjo është bërë për arsye të caktuara, mendojnë që pas një periudhës dhjetë vjeçare të zbatimit të këtij ligji, ndoshta nevojat e zhvillimit të Kosovës e kërkojnë që në mjetet e buxhetit të ketë fonde të destinuar. E kemi pas ligjin për taksën e ekologjike dhe kemi pasur probleme për shkak të këtij kufizimi, apo e kemi edhe rastin e fondeve të privatizimit për të cilat asnjë garancë nuk ipet se do të destinohen për investime kapitale me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik. Çështja e tretë më intereson të dijë sa praktikohet në ministri dhe në agjencitë buxhetore, raporti mbi efektet e projekteve të investimeve kapitale, sepse kjo do të ndihmonte që për projektet e ardhshme të marrim vendime më të mira. A ka procedura për këtë dhe a ka raportim të agjencive për efektet e këtyre projekteve.

Latif Gashi mendoj që kjo çështje nuk është dashur të hyjë si pikë e rendit të ditës. Si komisioni kemi caktuar një grup punues për monitorimin e ligjit dhe këto tema që po zhvillohen është dashur të trajtohen në grupin punues dhe të shihen defektet dhe pengesat dhe gjithçka që është në favor të plotësimit dhe ndryshimit të ligjit. Pasiqë grupi punues të kryej punën dhe hartojë raportin me rekomandime, atëherë ne si komision kemi mundësinë të diskutojmë çështjet e ngritura në raport.

Kryetarja sqarojë se është praktikë se sa herë që fillohet me monitorimin e ligjit, sipas planit të veprimit të fillohet me raportimin e ministrit në komision, dhe kjo ka ndodhur edhe në ligjet që i kemi monitoruar më herët. Pra janë rregullat e punës gjatë monitorimit të ligjit, ia kemi dërguar pyetjet ministrit i cili na përgjigjet dhe ato janë punë bazë për punën tonë të mëtutjeshëm edhe për hulumtimet deri ku ka shkuar me zbatueshmëri ligj.

Latif Gashi ideja ime ishte që ne nuk do të duhej të merremi me detale, do të duhej të fokusohemi në raportimin për pyetje e parashtruara dhe pastaj të vazhdohet puna në teren.

Kryetarja lexoi nenin 73.2 të Rregullores së punës së Kuvendit, ku thuhet se ministri raporton një herë në vit për zbatueshmërinë e ligjit, dhe radhitja e kësaj pike të rendit të ditës është në përputhje me rregulloren e Kuvendit.

Sali Asllanaj theksoi se për këtë ligj, ndoshta kemi bërë një monitorim indirekt vitin e kaluar kur kemi monitoruar ligjin për financat e pushtetit lokal. Në vizitat në komuna dhe në takimet me zyrtarët komunal, ndër vërejtjet që kishin për zbatueshmërinë e atij ligji, ishin edhe ndalimet që iu bëhen nga Ligji i Menaxhimit të Financave Publike, siç është rasti kufizimi të lirisë së komunave për ridestimin e mjeteve në projekte të caktuara. Po ashtu kemi pasur vërejtjet, siç rasti në komunën e Ferizajit, që thonin se në fazën e planifikimit të buxhetit ministria na e dikton apo limiton planifikimet buxhetore. Mendojë që komunave do të duhej ti krijohet një mekanizëm i rëndësishëm i cili do të lejonte fleksibilitet në ridestimin e mjeteve në mes

projekteve. Sa i përket organizimit të drejtorisë së buxhetit, mendoj që nëse është në funksion të autonomisë unë jam udhëtar i saj, por deri atëherë do të duhej të mbetej drejtoria e buxhetit për financat lokale, pasi që komunat mund ta ndijnë veten me të sigurt dhe do të kenë adresë për adresimin e kërkesave dhe të drejtat të tyre.

Hasime Krasniqi theksoi se mbështet pjesërisht mendimin e të deputetit Gashi, që të mos humbim kohë. Përderisa ministri i ka përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe fokusi le të jetë këtu, dhe nëse dikush prej deputeteve ka pyetje shtesë, le ti drejtohet ministrit, i cili mund ti përgjigjet konkretisht në pyetjen e pareshtur dhe mos të lëshohemi në debat të gjërë, dhe le ti mbetet grupit punues gjatë vizitave të trajtojë më në detale të gjitha çështjet e interesuara.

Bedri Hamza vazhdoi në përgjigje në pyetjet tjera të parashtruara me shkrim. Informoi se Korniza Afatmesme e Shpenzimeve përgatitet në përputhje me dispozitat e ligjit. Ndërkaq Thesari përgatit për çdo vit strategjinë e borxheve ku përfshihen të gjitha detajet e borxheve shtetërore i cili dokument është pjesë e Ligjit të buxhetit. Misioni dhe lista e qëllimeve dhe objektivat që mund të maten janë pjesë e KASH, ndërsa në ligjin për buxhet ato shndërrohen në aktivitete dhe numra. Thesari ka Sistemin për Menaxhimin e Financave Publike i cili siguron dhe nuk lejon tejkalimin e fondeve të përvetësuar. Deri me tani nuk ka pasur asnjë vendim për reduktimin e alokimeve nga të ardhurat vetanake të Komunave. Thesari ka nxjerr Rregullën Financiare për raportim të faturave të papaguara nga organizatat buxhetore dhe po ashtu ka formuar njësinë për monitorimin e pagesave të vonuara. Kanë ekzistuar ankesa nga ana e OB-ve, megjithatë Ministria e Financave është e obliguar të zbatojë vendimet gjyqësore të formës së prerë. Deri më tani nuk ka pasur detyrime të tilla dhe si rezultat as analiza të riskut. Komunat i dozojnë raportet vjetore financiare Drejtorit të Thesarit të parapara sipas ligjit, përveç tri komunave (Leposaviq, Zubin Potok, dhe Zveçan). Gjithashtu, komunat dhe agjencitë e pavarura dorëzojnë edhe propozim buxhetin e tyre konform afateve dhe qarkoreve të përcaktuara nga ana e Ministrisë së Financave. Sa i përket formës së propozimeve, ato shpesh i tejkalojnë kufijtë e përcaktuar me qarkore buxhetore. Ndërkaq në pyetjen se sa zbatohet neni 36 i Ligjit për ndryshim dhe plotësim të ligjit nr. 03/L-48 për MFPP, nga ana e OB me rastin e inicimit të procesit të prokurimit, njoftoi se nuk ka informata sa i përket zbatimit të këtyre kërkesave. Sa i përket respektimit të nenit 80 të ligjit, theksoi se është përgjegjësi MAP dhe të gjitha organizatave buxhetore dhe institucioneve tjera publike që të zbatojnë këtë dispozitë dhe jo vetëm e MF-së. Megjithatë ka vend që në rast të ndryshimeve eventuale të këtij ligji të sqarohet dhe riformulohet ky nen, pasi që ka interpretime të ndryshme për zbatimin e tij.

Hykmete Bajrami pa patur tendencë për të bërë politikë, mendoj nuk besoj se dikush i kënaqur me rezultatet e regjistrimit të popullsisë. Janë raportuar më pak se 200.000 banorë për Komunën e Prishtinës, ndërkaq ne jemi dëshmitar se shumë më shumë njerëz jetojnë në Prishtinë, shfrytëzojnë shërbimet këtu por se janë regjistruar në komunat amë. Nuk do të ishte gabim të thuhet se procesi i regjistrimit të popullsisë ka dështuar, përkundër mjeteve të shumta që janë shpenzuar. Prandaj të formula e përcaktimit të grantit për komunat ose duhet me i ndërrue kriteret ose duhet me bërë diqka dhe të dhënat e fundit për banorët e Prishtinës nuk do të duhej të merren si bazë për ndarjen e grantit, pasi që siç e theksove nuk kemi të bëjmë me një të dhënë të saktë të banorëve. Ne e dimë edhe nga numri i nxënësve në shkolla apo nga fatura në shërbimet komunale dhe nga kalkulimet që janë bërë besohet se Komuna e Prishtinës duhet të ketë 400.000-500.000 banorë dhe kjo situatë e krijuar pas publikimit të rezultateve nga regjistrimi i popullsisë, ka me qenë problematike gjatë përgatitjes së buxhetit për vitin e ardhshëm. Sa i përket nenit 80, pajtohem se është një nen problematik dhe ka nevojë për rishikimin e tij, pasi që që nuk mund të ketë pagesë shtesë për punën shtesë që bëhet brenda orarit, apo nuk mundet një anëtar i bordit të merr pagën e barasvlershëm me një të ministri. Një çështje tjetër ndërlidhet me atë që tha prof. Mustafa për fondet e destinuar, ne kemi disa ligje që po mbesin peng për shkak të kufizimeve të mëdha buxhetore apo mungesa e fondeve të destinuara. Ndoshta mund të krijohet konfuzion krijimi i mundësisë ligjore që të hyrat të jenë të dedikuara, kur nuk mirëpo për fondet e privatizimit duke të ekzistojë baza ligjore për destinimin në projekte zhvillimore strategjike. Mendojë që kjo nuk duhet të mbetet vetëm barrë e Qeverisë, por edhe Kuvendit të kyçet në këtë proces dhe një pikë e rezolutës në Kuvend, të jetë edhe

çështja e vendosjes për mjetet e privatizimit dhe të thuhet në vija të trasha që këto mjete do të shkojnë për investimet kapitale afatgjate që garantojnë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe ato nuk do të mund të shpenzohen për shpenzime operative.

Bedri Hamza në pyetjet e ngritura shtesë, sqaroi se kemi filluar të ta përgatisim buxhetin sipas sistemit të ri që kërkon që të gjitha projektet që bëhen pjesë e tabelave të buxhetit duhet ti plotësojnë kriteret për vitin e caktuar dhe ka avansime në këtë drejtim. Gjithashtu është edhe komisioni për investime publike, i cili bënë vlerësimin e të gjitha projektet në vlera më të mëdha në aspektin e arsyeshmërinë së tyre. Ndërsa sa i përket të hyrave me destinim të caktuar, kemi raste edhe kur ligj lejon të hyrat e dedikuara, siç është rasti për agjencionet e pavarura, rasti i AKP-së ku 5% nga fondi i totalit nga procesi i privatizimit përdoren për financimin e nevojave të këtij agjensioni. Po ashtu të hyrat vetanake të komunave janë të dedikuara për komunat. Mendoj që nuk është në interes që të ketë ndonjë lidhje ekzakte të burimet të financimit në të gjitha rastet. Sa i përket dedikimeve buxhetore në buxhetin e viti 2013 do të ketë avancim për komunat, që do të kenë autonomi të plotë në destinimin e të hyrave vetanake sipas kategorive që kanë nevojë dhe me këtë jemi të harmonizuar me FMN-në. Sa i përket planifikimit të buxhetit, si Ministri e Financave kërkojmë që organizatat buxhetore të jenë të kujdesshme, të mos planifikohen projekte që nuk janë të siguruar financimin e sigurt. Sa i përket regjistrimit të popullsisë nuk do të analizojë çështjen e pranimit apo kontestimit të tyre, dhe të dhënat e publikuar nga regjistrimi i popullsisë nuk janë reflektuar në buxhetin 2013 dhe komisioni i granteve e ka kryer punën në pajtim me ligjet në fuqi dhe ne e kemi përgatit buxhetin sipas gjendjes dhe kriterëve ekzistues. Ne kemi biseduar edhe me FMN, dhe nuk jemi të interesuar të shkurtojmë fondin në mënyrë drastike për asnjë komunë. Të hyrat nga privatizimi janë të hyra të njehershme për buxhetin e Kosovës dhe me qëllim të ruajtjes së stabilitetit makro-fiskal, mendoj që nuk duhet që buxheti i shteti të bazohet në të hyrat e njehershme, posaçërisht për shpenzimet rrjedhëse dhe pajtohem që këto të hyra të lidhen edhe me projektet kapitale afatgjate.

Ali Sadriu pyeti ministrin se me rastin e dorëzimit të qarkoreve buxhetore, a i kërkon organizatave buxhetore deklarimin e donacioneve shumë vjeçare, sepse kemi raste kur organizatat kërkojnë mjete shtesë dhe donacionet ua teprojnë për disa vite, siç është rasti te avokati i popullit. Pastaj një problem tjetër është shfrytëzimi i pjesës më të madhe të buxhetit në tremujorin e fundit, me ligj është e rregulluar kuota sa mund të shpenzohet në tre muajt e fundit dhe kjo nuk respektohet. Neni 80 lenë shumëçka me diskutuar dhe duhet rregulluar. Kemi raste kur institucionet e ndryshme siç është Universiteti i Prishtinës apo Kompania Hidrodrini kanë marrë disa paga në emër të performacës së mirë.

Kryetarja sugjeroi që anëtarët e komisionit, në pyetjet e tyre të fokusohen në nenet përkatëse të ligjit.

Xhevdet Neziraj theksoi se është mirë që pjesë e grupit punues janë edhe anëtarët e Komisionit për Mbikëqyerjen e Financave Publike, duke pasur parasysh faktin se ky komision ka pasur një takim më të gjitha komunat dhe kanë pasur mundësi të identifikojnë të metat e këtij ligji në këtë çështje. Jemi dëshmitar se pothuajse të gjitha komunat dhe agjencionet buxhetore po dalin me të meta nga auditimi i jashtëm që iu është bërë dhe është mirë që po monitorohet ky ligj dhe të shihen në praktikë të metat dhe të rekomandohet që të evitohen në mënyrë që ligji të jetë i zbatueshëm në praktikë.

Sali Asllanaj theksoi sot po bisedojmë për parimet e zbatimit të ligjit dhe diskutimi nën për nën mund të bëhet kur të realizohen vizitat në terren. Mendojë që vërejtjet e kryetarit të komisionit për mbikëqyerjen e financave publike ishin shumë serioze dhe nuk duhet të ndërhyhet në shprehjen e mendimeve.

Bedri Hamza njoftoi se memorandumet e mirëkuptimit janë eliminuar dhe nuk janë pjesë e tabelave të buxheti. Nëse iu referohemi raporteve të fundit të auditorit gjeneral, shifet se kemi një përmirësim të vazhdueshëm në menaxhimin e financave publike.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-87 për Parkun Kombëtar "Sharri", me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor dhe Projektligjit nr. 04/L-87 për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetarja theksoi se këto dy pika që kanë të bëjnë me projektligjet për parqet kombëtare, kanë nevojë për shqyrtim shtesë në aspektin e vlerësimit të ndikimeve buxhetore dhe është e domosdoshme që në takim të ftohet ministri i ministrisë sponsorizuese dhe ai i financave për të trajtuar disa çështje të rëndësishme që përmbajnë projektligjet. Prandaj propozoj që të shtyhen për shqyrtim në mbledhjen e radhës së komisionit.

Latif Gashi mbështeti propozimin për shtyerjen e shqyrtimit të projektligjit dhe vlerësoj se në takim duhet ftohen tre ministrat, ministri i ambientit, i bujqësisë dhe i financave. Kjo për arsye se çështjet që pretendohen të kalojnë tani në kompetencë të ministrisë së ambientit, kanë qenë kompetencë e ministrisë së bujqësisë dhe pylltarisë. Me që me këto projektligje, pretendohet të bëhen parqe nacionale 27% e pyjeve në Kosovë dhe një punë e tillë mbikëqyrëse nuk mund të bëhet nga 17 punëtorë. Disa zona që pretendohet të bëhen parqe ka pasuri private dhe aty duhet të bëhet shpronësimi. Pra ka shumë çështje për trajtim dhe sqarim dhe është e domosdoshme të ftohen tre ministrat e përmendur.

Kryetarja theksoi se e ka ngritur me qëllim këtë çështje, sepse sipas deklaratës financiare, projektligjet përmbajnë kosto të lartë buxhetore dhe është e domosdoshme të sqarohen disa gjëra që përmbajnë këto projektligje.

Pas propozimeve, Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Projektligji për Parkun Kombëtar "Sharri" dhe Projektligji për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna, me raportet e komisionit funksional, shtyhen për shqyrtim në mbledhjen e radhës së komisionit, në të cilën mbledhje do të ftohen Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministri i Financave për të dhënë arsyetimet për ndikimin buxhetor shtesë të projektligjeve.

8. Projektligjit nr. 04/L-21 për Mbrojtjen e Konsumatorit, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

9. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-082 për shfuqizimin e neneve 37, 38 dhe 39 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, me Raportin me amendamente të Komisionit funksional për Legjislacion

Komisioni njëzëri nxori këtë

REKOMANDIM

Projektligji dhe amendamentet e komisionit funksional nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

10. Të ndryshme

10.1. Kryetarja theksoi se projektligji për pagat e funksionarëve të lartë publik është shqyrtuar nga komisioni funksional dhe do të jetë pikë e radhës në seancën plenare të radhës. Besoj se e keni shikuar projektligjin dhe keni vërejtje se shumë çështje kanë nevojë të rregullohen. Është në interes edhe të komisionit tonë që çështja e pagave të funksionarëve publik, sidomos të agjencioneve dhe institucioneve të pavarura të rregullohet, pasi që jemi ne që po ballafaqohemi me probleme dhe kërkesa për përcaktimin e pagave dhe me mungesën ligjore për këto çështje. Janë mbi 32 agjensione që i përgjigjen Kuvendit dhe përgjegjësinë e marrim ne si Kuvend dhe qeveria nuk ka kurfarrë kompetence për këtë punë. Rasti i fundi ishte një takim që kisha me anëtarët e sapo zgjedhur të KPM-së, të cilët kur kanë kuptuar pagat e tyre janë në formë të kompenzimit kanë kërkuar të rregullohet kjo çështje dhe iu kam thënë se ligji duhet të rregullojë këtë punë. Kryetarja kërkoi pëlqimin e anëtarëve të komisionit për qfarë edhe mori pëlqimin, që ajo në emër të komisionit të ngris këtë çështje në seancë dhe të kërkojë që të krijohet një grup i përbashkët punes në mes dy komisioneve dhe bashkërisht të punojmë në formulimin e amendamenteve.

Hykmete Bajrami ne kemi biseduar edhe më herët se parasegjithash është e rëndësishme të kategorizohen agjensionet përkrah pesha e rëndësisë, kompleksiteti të punes dhe për nga detyra e tyre që e kryejnë. Me këtë ligj nuk kemi mundësi me e bë këtë, vetëm nëse ia ndërrojm krejt natyrën e ligjit. Për të rregulluar kategorizimin e pagave, ne na duhet ta bëjmë së pari kategorizimin e agjencioneve, për me pas më të lehtë edhe justifikimin në përcaktimin e nivelit të pagave.

Kryetarja ne kemi një bazë dhe të rregullojmë atë. Kam biseduar edhe me projektin GIZ dhe kam kërkuar që ta kemi një model të Gjermanisë se si janë të ranguar pagat e funksionarëve të lartë publik atje sipas pozitave të caktuara dhe si bëhet vlerësimi i pagave. Po ashtu e kemi në dispozicion ligjin e Shqipërisë dhe do të shfrytëzojmë eksperiencën për këtë çështje nga vizita që jemi duke e planifikuar në Kroaci, për të cilën në bashkëpunim me protokollin e Kuvendit dhe GIZ, përmes Ambasadës së Kosovës në Kroaci, janë duke u bërë përpjekjet për realizimin e një vizite studimore që është planifikuar të realizohet në muajin tetor.

10.2. Kryetarja në mbledhjen e fundit kemi vendosur që si komision të marrim iniciativën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për fondet pensionale të Kosovës, për shkak të problemeve ligjore në përcaktimin e taksës menaxhuese. Prandaj sot do të duhej të caktonim grupin punues që do të merret me këtë punë. Propozoi anëtarët e grupit punues për hartimin e projektligjit, të cilat u miratuan njëzëri me këtë përbërje: **Safete Hadergjona, Naser Osmani, Jelena Bontic, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj dhe Latif Gashi.**

Mbledhja përfundoi: 12:45

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadergjona